



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 18 tetor 2021
Nr.ref.:RK 1869/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI39/21

Parashtrues

Abdullah Marmullaku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr.
3271/2006 të 8 tetorit 2008**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Avdulla Marmullaku nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr. 3271/2006, të 8 tetorit 2008, përmes të cilit është refuzuar ankesa e tij kundër Vendimit nr. 80/06 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të 9 nëntorit 2006, lidhur me ankesën kundër Aktvendimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Shërbime Publike në Komunën e Klinës nr. 07-354-859, të 1 korrikut 2005.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, si dhe të gjitha vendimeve dhe aktvendimeve tjera të autoriteteve publike, përmes të cilave pretendohet se parashtruesit të kërkesës i *„janë shkelur të drejtat dhe lirit themelore të garantuara në kushtetutën e Republikës së Kosovës“*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 26 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 2 mars 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Me të njëjtën shkresë, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të shpjegojë a) cilin vendim të autoritetit publik ai e konteston në Gjykatë, b) cilat të drejta dhe liri kushtetuese i janë shkelur atij, dhe c) të dorëzojë në Gjykatë të gjitha informatat përkatëse, duke përfshirë të gjitha vendimet në lidhje me kërkesën e tij.
8. Më 16 mars 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesën e plotësuar në të cilën a) nuk specifikoi se cilin vendim të autoritetit publik e konteston në Gjykatë, b) cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur, c) nuk dorëzoi vendime të reja në Gjykatë, por dërgoi vendime që tashmë ishin pjesë integrale e kërkesës së 23 shkurtit 2021.

9. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.
10. Më 7 qershor 2021, Gjykata përsëri i dërgoi një shkresë parashtresit të kërkesës duke kërkuar nga ai që: a) të deklarojë se cilin vendim të autoritetit publik ai e konteston në Gjykatë, b) t'i shpjegojë Gjykatës se me cilin vendim të autoritetit shtetëror i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë
11. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 1 korrik 2021, Gjykata pranoi përgjigje nga parashtresi i kërkesës ku thuhej: *“se ai para gjykatës konteston Konkluzionin nr. 07-354-859 të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Shërbime Publike të Komunës së Klinës të 28 prillit 2006”*. Përveç kësaj, parashtresi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë edhe disa dokumente, të cilat nuk janë relevante për rezultatin e procedurës së tij.
13. Më 10 shtator 2021, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se më 1 korrik 2005, Drejtoria për Urbanizëm dhe Shërbime Publike në Komunën e Klinës nxori Vendimin nr. 07-354-859, me të cilën urdhëroi parashtresin e kërkesës, *“që të kryejë veprime të caktuara në lidhje me rrënimin e objektit – shtëpisë së ndërtuar pa leje ndërtimi”*.
15. Nga shkresat e lëndës rrjedh që parashtresi i kërkesës nuk i ka kryer veprimet dhe nuk ka vepruar në përputhje me vendimin nr. 07-354-859 të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Shërbime Publike.
16. Më 1 nëntor 2005, Drejtoria për Urbanizëm dhe Shërbime Publike e Komunës së Klinës nxori konkluzionin 07-354-859, përmes të cilit lejohet ekzekutimi i aktvendimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Shërbime Publike nr. 07-354-859 të 1 korrikut 2005.
17. Më 28 prill 2006, parashtresi i kërkesës parashtroi ankesë në Bordin e Ankesave të Komunës së Klinës kundër Aktvendimit nr. 07-354-859 të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Shërbime Publike të 1 korrikut 2005.

18. Më 9 qershor 2006, Bordi i Ankesave nxori Aktvendimin 1/3 nr. 354-163/2006, përmes të cilit hedhet poshtë ankesa e parashtruesit të kërkesës si e paafatshme, duke deklaruar „Kryeshefi Ekzekutiv në cilësinë e kryesuesit të Bordit të Ankesave duke ju referuar kompetencës së tij nga Rregullorja pozitive, me datën 09.06.2006 pasi ka shqyrtuar afatëshmërinë e ankesës, të njëjtën e REFUZOJ si të jashtafatshme, për shkakun se Aktvendimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Shërbime Publike, është pranuar nga pala me datën 02.11.2005, gjë të cilën e vërteton edhe fletëkthesa përkatëse“.
19. Parashtruesi i kërkesës kundër aktvendimit 1/3, nr. 354-163/2006 të Bordit të Ankesave, parashtroi ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
20. Më 9 nëntor 2006, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxori Vendimin nr. 80/06, përmes të cilit refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke deklaruar:

„Në bazë të Aktvendimit të Kryeshefit Ekzekutiv dhe kryesues i Bordit të Ankesave me dt 09.06.2006 ka shqyrtuar afatshmërinë e Ankesës së palës, e njëjta është hedh si e jashtë afatshme për arsye se Aktvendimin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Shërbime Publike, pala e ka pranuar me dt: 02.11.2005, e cila është vërtetuar nga fletëkthesa e bashkangjitur në shkresat e lëndës, kurse pala ankimin e ka bere me dt: 28.04.2006.

Pas administrimit të provave gjetëm se Ankesa është e pa afatshme dhe se Aktvendimi Kryeshefit Ekzekutiv KK Klinës, me të cilin i është refuzua Ankesa e palës, është i ligjshëm”.

21. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër aktvendimit nr. 80/06 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
22. Më 8 tetor 2008, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin A. nr. 3271/2006, përmes të cilit refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në përfundim të aktgjykimit, Gjykata Supreme deklaroi: „Nga shkresat e lëndës shihet se inspektori i ndërtimtarisë, me dt. 22. 06. 2005, duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka dal në vendin e ngjarjes dhe në procesverbal ka konstatuar se [...] objekti posedon leje të përkohshme ndërtimi dhe se objekti është ndërtuar para lufte, me dimensione 6x1 m.

Sipas nenit 41 të Ligjit mbi Ndërtimin e Objekteve Investive (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 5/86), ndërtimi, përkatësisht rikonstruktimi i objektit mund të fillojë pasi të merret leja për ndërtim. Lejen për ndërtimin e objektit e jep organi komunal i administratës kompetent për punët e ndërtimtarisë, ndërsa sipas nenit 64.2 te Ligjit për Ndërtim (gazeta zyrtare 2004/15), përveç tjerash është përcaktuar se heqja ose rrënimi i objektit kryhet kur objekti është ndërtuar ose është vendosur rishtas pas ndërtimit pa leje ndërtimi.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit...”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikoi në kërkesë cilat të drejta kushtetuese dhe liri themelore i janë shkelur me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, si dhe me vendimet dhe aktvendimet e autoriteteve të tjera publike.
24. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se *„nga autoritetet publike janë shkelur të drejtat dhe lirit themelore të garantuara në kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë aplikuar gabimisht të drejtën materiale“*.
25. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës i lidh shkeljet e pretenduara me faktin *“se vendimi për rrënim është pru në emër të banuesit, për këtë nuk kam qen i njoftuar edhe as prezent kur është rrënu shtëpia”*.
26. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: *„Kuvendi Komunal Klinë të ma kompenzoi shtëpin e banimit në shumë prej 70.000 Euro, ose të paguhet të gjitha paisjet dhe orendit komplet prej kulmit deri në temel”*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

29. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kriteret tjera të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

30. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe se ka specifikuar aktin e autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit e konteston në Gjykatë.

31. Megjithatë, Gjykata merr parasysh edhe nenin 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

32. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]*

*c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe
[...].”*

33. Në lidhje me këtë, në vlerësimin nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara përmes nenit 49 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse kriteri për afatin 4 (katër) muajor i përcaktuar në Ligj dhe Rregullore të punës është respektuar në raport me „vendimin e fundit”, i cili është nxjerrë si rezultat i “vendimit efektiv juridik”, siç përcaktohet me kriteret e pranueshmërisë të parapara në Rregulloren e punës.

34. Prandaj, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës vetëm në përgjigjen të cilën Gjykata e pranoi më 1 korrik 2021, deklaroi në mënyrë specifike se “para gjykatës konteston Konkluzionin nr. 07-354-859 të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Shërbime Publike të Komunës së Klinës të 28 prillit 2006”.

35. Megjithatë, duke pasur parasysh rrugën procedurale të rastit në lidhje me Aktvendimin e kontestuar nr. 07-354-859, Gjykata konstaton se parashtruesi i

kërkesës me qëllim të përcaktimit të bazueshmërisë dhe ligjshmërisë së Aktvendimit të kontestuar nr. 07-354-859, ai ka shfrytëzuar mjetet juridike të përcaktuara me ligj, në bazë të të cilave autoritetet publike kompetente dhe gjykatat morën vendimet e tyre, si në formën e konkluzioneve ashtu edhe në formën e aktvendimeve, vendimeve dhe aktgjykimeve, gjatë vlerësimit të bazueshmërisë dhe ligjshmërisë së aktvendimit të kontestuar, që mund të shihet në bazë të shkresave të lëndës.

36. Gjykata konstaton se mjeti i fundit juridik i përcaktuar me ligj, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka përdorur për të kontestuar Aktvendimin nr. 07-354-859, si dhe vendimet e tjera të autoriteteve publike ishte parashtrimi i ankesës në Gjykatën Supreme, në të cilën ai kontestoi vendimin nr. 80/06, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të 9 nëntorit 2006, në lidhje me ligjshmërinë e Aktvendimit nr. 07-354-859.
37. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme, lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës, më 8 tetor 2008, nxori Aktgjykimin A. nr. 3271/2006, përmes të cilit ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër ligjshmërisë së Aktvendimit nr. 07-354-859, të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Shërbime Publike, e shqyrtoi në merita. Mbi këtë bazë, rezulton se pikërisht ky Aktgjykim i Gjykatës Supreme, është edhe vendimi i fundit i nxjerrë si rezultat i një “mjeti efektiv juridik” në rastin konkret.
38. Gjykata, duke pasur parasysh të gjitha faktet e rastit konkret, përkatësisht që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme A. nr. 3271/2006 i 8 tetorit 2008, dhe se parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 23 shkurt 2021, arrin në përfundimin se kërkesa e parashtruesit ishte parashtruar jashtë afatit 4-mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
39. Gjykata dëshiron të theksojë në veçanti se Kushtetuta ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, që kur Gjykata ka juridiksion kohor për t’u marrë me shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësinë pasi mori Aktgjykimin A. nr. 3271/2006 të Gjykatës Supreme të 8 tetorit 2008, që brenda 4 muajve, t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, e cila tashmë kishte juridiksion kohor për të shqyrtuar kërkesat e parashtruesve për shkelje të mundshme të Kushtetutës.
40. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t’u kontestuar (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Sabri Gunes kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39; dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24).

41. Prandaj, në bazë të arsyeve të cekura më lart, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Jusa Caka-Nimani